

Prof. Ass. Dr. Halil Asllani



Profesor në Fakultetin për Siguri Publike për këto lëndë:

1. Gjuhë angleze I
2. Gjuhë angleze II
3. Shkrim akademik
4. Anglishtja për qëllime specifike

Fushat e interesit:

Applied Linguistics

Teaching English as a Second Language

Second Language Acquisition

Psycholinguistics

Second Language Research Methods

Corpus Linguistics

Educational Technology

Computer Assisted Language Learning (CALL)

Morphology

Halil Asllani ka përfunduar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Për rezultate të mira gjatë studimeve është shpërblyer me bursë universitare. Studimet postdiplomike i vazhdoi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, në drejtimin e Gjuhësisë. Me përfundimin e studimeve të nivelit master mori gradën shkencore: Master i Shkencave Filologjike, drejtimi: Gjuhësi Angleze. Në Universitetin e Prishtinës ka mbaruar edhe studimet themelore në degën e Gazetarisë, ku mori gradën shkencore: Baçelor i Gazetarisë.

Studimet e doktoraturës i përfundoi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, me ç'rast mori gradën shkencore: Doktor i Shkencave Filologjike (Dr.sc.), programi Gjuhësi (nga grupshkenca të nxënit e gjuhës, me koncentrim në gjuhën e dytë (angleze)).

Gjatë studimeve të nivelit master qëndroi për gjysmë viti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për qëllime të njohjes me gjuhën dhe kulturën amerikane si fushë studimi. Ka realizuar vizita të ndryshme studimore dhe ka prezantuar në konferenca në disa vende të botës (Amerikë, Austri, Gjermani, Poloni, Finlandë, Turqi, Slloveni etj.). Përveç pjesëmarrjeve dhe prezantimeve në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ka të botuara disa punime shkencore të indeksuara në platforma relevante.

Në vitin 2017 ka përfunduar një mobilitet akademik në fushën e hulumtimeve në Police University College (POLAMK) në Finlandë. Në vitin 2019, në kuadër të programit Erasmus +, ka realizuar një vizitë studimore në Berlin, Gjermani. Ndërsa, në vitin 2021 ishte ligjërues vizitor në Varshavë, Poloni, në kuadër të shkëmbimeve të stafit akademik përmes programit Erasmus +.

Ka mbaruar edhe disa kurse ndërkombëtare në UVNP në fushën e gazetarisë dhe të drejtave të njeriut.

Halil Asllani ka thirrjen akademike profesor asistent dhe ka përvojë mbi pesëmbëdhjetë vjeçare në mësimdhënie. Ka ligjëruar në disa universitete publike dhe private në Kosovë. Ka qenë ligjëruesi rregullt në kolegjin AAB në Prishtinë. Ka ligjëruar për disa vite edhe në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Ekonomik në lëndët Business English I dhe Business English II. Në Universitetin e Prishtinës ka ligjëruar edhe në Fakultetin e Edukimit. Ka përvojë të gjatë në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë duke përfshirë Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Tani është mësimdhënës i rregullt në Fakultetin e Sigurisë Publike, në thirrjen akademike profesor asistent, si dhe i angazhuar në Universitetin e Prishtinës.

E-mail: halil.asllani@rks-gov.net
halil.asllani@uni-pr.edu

Tel: 028/590-070

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Fakulteti i Sigurisë Publike